



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 9532/2022  
Data: 14.11.2022

### PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e dhjetë -X- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 27.10.2022 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtore për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Amir Berisha** (Përfaqësues nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim), **Ilir Kaloshi** (Përfaqësue nga N.P.L Pastrimi sh.a). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti finansiar për periudhën Janar – Shtator 2022.
3. Plani i biznesit të N.P.L Pastrimi sh.a. për vitin 2023.
4. Miratimi i draft rregullores për administrimin e shtëpisë së kulturës në komunën e Hanit të Hanit të Elezit.
5. Plotësim ndryshimi i rregullores për Transportin Rrugorë në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit.
6. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.
7. Raporti për vlerësimin e performancës së Komunës për vitin 2021.
8. Informatë e DKA-së mbi suksesin e arritur përfundin e vitit shkollor 2021/2022 në SHFMU dhe SHML.
9. Raporti finansiar për periudhën Janar – Shtator 2022 i N.P.L Pastrimi sh.a.
10. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

## **1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

**Kryesuesi** thekson:- a keni ndonjë vërejtje rrith procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### **U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR**

## **2. Raporti finançiar për periudhën Janar – Shtator 2022.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- buxheti i miratuar për vitin fiskal 2022 është në shumë prej 2,759,758.00 €, Ndërsa buxheti përfundimtarë është 2,942,586.08 €, ku në këtë shumë përfshihen: Bartja e të hyrave vetanake të pa shpenzuara të vitit 2020 dhe 2021 në vlerë prej 72,737.76 €, Grant shtesë për projektin kapital “Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe rregullimi i rrjetit të ujësjellësit” në vlerë prej 37,150.00 €, Donacion prej IPA Fondeve për projektin “Mbrojtja e mjedisit përmes përmirësimit të ujërave të zeza dhe Kanalizimeve Atmosferike” në shumë prej 64,140.32 €. Në kategorinë Paga dhe shtesa shpenzimi është në shumë prej 1,168,274.23 € apo 66.53%, në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 216,450.22 € apo 56.08%, në kategorinë ekonomike shërbime komunale shpenzimi është në shumë prej 43,589.27 € apo 64.39%, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 67,650 € apo 84.56%, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale kemi shpenzuar 208,714.90 € apo 45.87%. Totali i shpenzimit për periudhën Janar - Shtator të vitit 2022 është në shumë prej 1,704,678.62 € apo 61.77 %. Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtoj gjithsej 264,541.72 € për periudhën janar-shtator 2022 dhe paraqesin 67.37 % e planit të të hyrave vetanake, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2021 kemi një rritje prej 16,419.20 €. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Refet Kalisi** thekson:- krahasimet nuk përputhen te shpenzimet kapitale te objekti i shëndetësisë. E njëjtë është edhe te çështja e kanalizimeve dhe ujësjellësit.

**Hyriete Isufi** thekson:- shpenzimet për paga janë më të vogla në këtë vit, a është zvogëluar numri i stafit apo ku është problemi.

**Lindita Ballazhi** thekson:- numri i stafit është i njëjtë por ndoshta qëndron fakti që zyrtarët nuk kanë pranuar orë shtesë .

**Ajnure Thaçi** thekson:-te subvencionet dhe transferet është një rritje dhe mendojë që është pozitive . A janë dorëzuar raportet financiare për këtë kategori përfituese dhe a është caktuar ndonjë zyrtarë përgjegjës për monitorimin e shpenzimeve.

**Lindita Ballazhi** thekson:- ende nuk është publikuar raporti i shpenzimeve por edhe do të caktohet zyrtari për monitorimin e shpenzimeve.

**Sherif Berisha** thekson:- shpenzimi i investimeve kapitale për këtë nëntë mujorë është i mangët dhe muaji nëntor është fazë e fundit e projekteve kapitale por edhe pse jemi komunë e vogël bëjmë pjesë në rangun më të ulët të shpenzimeve kapitale. Kërkoj sqarim për shkuarjen me vetura private dhe faturimi në buxhet të komunës edhe pse nuk jeni ju vetëm si rast por mund të ketë edhe raste të tjera të kësaj natyre. A keni shkuar me veturë private dhe a e keni faturuar derivatin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- unë i raportojë Kryetarit të Komunës dhe ai ka pasur informacione se ku jam , mirëpo kemi pasur punë zyrtare dhe nuk kemi pasur veturë që kemi mundur me shfrytëzuar dhe më është dashur ta shfrytëzojë veturën time personale.

**Sherif Berisha** thekson:- me sa jam i informuar komuna i ka dhjetë vutura dhe nuk di që kemi mbetur ndonjë herë keq dhe nuk jeni vetëm ju si rast por ka edhe raste të tjera që mundem me i potencuar.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- shkuaria me vutura private mund të ndodhë dhe dje kemi pasur rast konkretë që nuk e kemi dërguar askënd sepse nuk ka pasur asnjë veturë. Dej kemi pasur kërkesë që z.Zaim Bela ka qenë prezentë dhe i kam sugjeruar që të paraqet kërkesë dje për me shfrytëzuar për ditën e sotme. Ka raste kur nuk ka vutura dhe e kemi atë mundësi që me ja siguruar udhëtimin por me veturë private dhe ne ja arsyetojmë faturën. Sa i përket këtij rasti nuk ka pasur vutura zyrtare dhe është dashur drejtoresha ta shfrytëzon veturën e vetë dhe nuk besojë që është diçka tragjike dhe tragjike është kur nuk e arsyeton shpenzimin. Mund të ndodhë edhe në të ardhmen që me shkuar me vutura private dhe me u arsyetuar përmes faturave sepse kjo ka ndodhur edhe më herët.

**Sherif Berisha** thekson:- pajtohem që ka ndodhur edhe herëve të tjera por nuk duhet me i lënë me i përsëritur dhe a mund ta dijë se a është shkelje apo jo.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- nuk është shkelje është e lejueshme për shkak se në mungesë të makinave lejohet sepse dihet se ku është tu shkuar , ndërsa shkelje mund të jetë kur nuk e arsyeton udhëtimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- në drejtori të financave kemi shumë lëndë që janë me afate të caktuara , me afate ligjore dhe nëse sot e kam afatin e fundit për me dërguar në Ministri të Financave do ta shfrytëzojë veturën time vetëm e vetëm mos me mbetur keç ndonjë punë në komunë prej të cilës varen shumë pasoja , në qoftë se nuk dorëzohet në afatin e fundit.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA RAPORTI FINACIARË PËR PERIUDHËN JANAR –SHTATOR 2022

#### 3. Plani i biznesit të N.P.L Pastrimi sh.a. për vitin 2023.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sherif Berisha** thekson:- si komision i aksionarëve nuk kemi mbajtur asnjë takim pavarësisht se e di kush është në bord por takime nuk kemi pasur asnjë herë . Materialet po përgatiten dhe nuk kam qasje në këto materiale dhe nuk e di nga ekzekutivi kush i përgatitë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- si anëtarë të komisionit të aksionarëve duhet t'i koordinoni takimet në mes veti si anëtarë të N.P.L Pastrimi sh.a.

**Refet Kalisi** thekson:- jam i kënaqur me shërbimet e kompanisë. Në këtë vit nga komuna është subvencionuar kompania në shumë prej 65 000 € dhe nëse kontraktobet ndonjë kompani është mirë që përmes kompanisë me u kontraktuar. Është mirë që me pasur auditim të kompanisë.

**Resul Suma** thekson:- përshëndesë planin e kompanisë sepse ka arritur me i eliminuar 97 % deponit e pa ligjshme të mbeturinave . Është mirë me bërë një studim të fizibilitetit që nëse në Kosovë hapen kompani të riciklimin me pasur të gatshëm planin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- kemi nënshkruar marrëveshje me dymbëdhjetë komuna që janë regionale për menaxhimin e integruar të mbeturinave. Duhet të jetë një plan i përbashkët i dymbëdhjetë komunave pastaj mund të hyjnë ata të cilët u potencuan. Ky është një plan biznesor për N.P.L Pastrimi sh.a.

**Ilir Kaloshi** thekson:- në Kosovë nuk e ka askush prej kompanive riciklimin e mbeturinave dhe nëse mendohet me bërë vetëm komuna jonë është një kosto e madhe.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA PLANI I BIZNESIT TË NPL PASTRIMI SH A PËR VITIN 2023

##### 4. Miratimi i draft rregullores për administrimin e shtëpisë së kulturës në komunën e Hanit të Elezit

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Hisni Luri** thekson:- irregullorja është shqyrtuar në komitet për politik e financa, në kuvendin e komunës dhe në debat publik. Propozimet nga debati publik i keni dhe krahas propozimeve që janë dhënë në debat propozoj që për nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e nëntë të jetë pa pagesë. Nëse keni edhe ndonjë propozim mund të parashtroni.

**Refet Kalisi** thekson:- e përkrahë këtë propozim që të jetë pa pagesë.

**Hyriete Isufi** thekson:- pavarësisht propozimeve që janë dhënë pa pagesë por ata lexues duhet me u mësuar që me pasur një rend, me pasur kartelë dhe nga klasa një deri në klasën e pestë është mirë që të jetë pa pagesë, ndërsa nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë së paku e kisha lënë një euro me paguar në vit në mënyrë që ta krijojmë një kulturë që duhet të mbajmë rend dhe t'i përbahemi irregullores.

**Kryesuesi** thekson:- propozimin e dhënë nga drejtori për arsim, kulturë, rini dhe sport e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rregulloren për administrimin e shtëpisë së kulturës në komunën e Hanit të Hanit të Elezit; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA DRAFT RREGULLORJA PËR ADMINISTRIMIN E SHTËPISË SË KULTURËS NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

##### 5. Plotësim ndryshimi i rregullores për Transportin Rrugorë në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Amir Berisha** thekson:- ndryshimet për këtë rregullore i kemi sqaruar pra te neni njëzet e tre është propozuar të hiqet shkronja (f). Nëse keni ndonjë propozim mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- arsyaja e propozimi ndryshimit të kësaj rregullore që e kemi propozuar është se kemi pasur kërkesë nga personat të cilët punojnë si auto taksi.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U VOTUA PLOTËSIM NDRYSHIMI I RREGULLORES PËR TRANSPORTIN RRUGORË NË TERRITORIN E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR DEBAT PUBLIK

## **6. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- nga nëntë të gjeturat për vitin 2021 të raportit të auditorit vetëm një është reduktuar pra është bërë funksionalizimi i sistemit të epasurisë, ndërsa të tjerat janë pjesërisht të zbatuara dhe disa ende nuk kanë filluar.

**Refet Kalisi** thekson:- a mendoni që do t'i realizoni të tjerat.

**Lindita Ballazhi** thekson:- do të mundohemi.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## **7. Raporti për vlerësimin e performancës së Komunës për vitin 2021.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Natyra Kalisi** thekson:- përveç materialit të cilin ua kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## **8. Informatë e DKA-së mbi suksesin e arritur përfundin e viti shkollor 2021/2022 në SHFMU dhe SHML.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Hisni Luri** thekson:- në material janë shënuar të gjitha informacionet në detale.

**Kryesuesi** thekson:- si është gjendja e nxënësve që është shtuar një klasë.

**Hisni Luri** thekson:- situata ka qenë e ndërlikuar përfshik se nxënësit të cilët janë qenë të përsëritur dhe janë mestuar pesë vajza përfshik se vetëm përfshik se është problem përfshik me shkollën profesionale dhe mundësia e udhëtimit ka qenë e vështirë. Pas shumë kërkave që kam pasur nga prindërit kam bërë që të arsytohen sepse udhëzimi administrativ potencion që të përfshikuar duhet të shkojnë në shkollën tjetër më të afërt. Me që shkollë të mesme më të afërt në komunën tonë nuk kemi dëgjuar që shkolla tjetër nuk ka përcaktuar që na jep zgjidhje tjetër dhe jemi detyruar që ta shfojmë një klasë.

**Kryesuesi** thekson:- a mendoni se ja keni cenuar ndonjë të drejtë ndonjë nxënësi sepse nuk e keni respektuar atë kur bëhet fjalë përfshik më të përafërt dhe ju keni potencuar se këtu nuk ka të drejtë dhe ka disa që janë munduar me shkollën me ndonjë komunë tjetër dhe udhëzimi nuk e jep këtë. Me çfarë baze është formuar kjo klasë dhe ndarja e nxënësve a është profesionale siç e keni postuar përfshik se kam ankesa prej prindërvëve.

**Hisni Luri** thekson:- kemi pritur një muaj e gjysmë përfshik me na i sjellë ditarët dhe në momentin që janë sjell ditarët i kemi shënuar po ata nxënës të cilët janë qenë në shkollë dhe në momentin që kemi marr vendim përfshik me kthyer ata nxënës të cilët janë përsëritur në të njëjtën shkollë është dashur me qenë me një klasë të tjetër dhe nuk besoj që kemi bërë të padrejtë. Më mirë do të ishte që këta nxënës të shkoni me ndonjë shkollë profesionale në mënyrë që në të ardhmen më lehët me gjet veten në punësim.

**Kryesuesi** thekson:- pse i keni kthyer prej shkollës profesionale.

**Hisni Luri** thekson:- ende nuk është vetëdija që për me ju sugjeruar për me shkuar në shkolla profesionale prindër janë arsyetuar që nuk i kemi kushtet për me udhëtuar.

**Kryesuesi** thekson:- këtë çështje e kemi diskutuar nga fillimi por un mendoj që ju është bërë dëm te nxënësit. Mësimi që zhvillohet ditëve të vikendit dhe nxënësit të cilët mungojnë a ju bëhet e pa arsyeshme mungesa dhe a ndëshkohen ata nxënës. Drejtoret e shkollave a e respektojnë orarin dhe nga kush kontrollohen.

**Hisni Luri** thekson:- mësimi zëvendësues që mbahet të shtuneve për shkak të grevës, në bashkëpunim me drejtoret e shkollave që me i shënuar sepse nëse nuk i shënojmë ju bëhet e padrejtë atyre tjerëve. Janë kujdestarët e klasave të cilët ua arsyetojnë apo nuk ua arsyetojnë mungesat nxënësve të cilët kanë munguar. Drejtoret e shkollave marrin leje me shkrim te drejtori i DKA-së.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- në mbledhjen prindërore në të cilën isha prezantë katër klasë ishin së bashku dhe dy arsimtarë u deklaruan që i bëjnë mungesat e arsyeshme e dy u deklaruan që nuk i bëjnë mungesat e arsyeshme.

**Nora Xhoni** thekson:- sa i përket mungesave është çështja te profesorët dhe nëse unë vajzën nuk e dërgoj në shkollë ditën e shtunë arsimtarit ja dërgojë një vërtetim dhe unë mendoj se e tërë Kosova e ka këtë problem.

**Hyriete Isufi** thekson:- transport për nxënësit të cilët udhëtojnë në Kaçanik ka për ata nxënës të cilët udhëtojnë për në shkollat profesionale. Nuk kemi të drejtë me pasur shkollë profesionale për shkak se nuk i ofrojmë mundësi. Nxënësve të cilët e kanë përsëritur vitin ua kemi dhënë mundësin përsëri por drejtori e potencoje mirë që ata nxënës që kanë shkuar në shkolla profesionale më lehët minden me hy në punë sepse ka raste që pas tri viteve po hynë në punë që do thotë në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare po punësohen.

**Kryesuesi** thekson:- unë nuk jam kundër askujt që e ka përgjegjësi me bërë një punë që i takon. Shkolla profesionale është shumë e mirë sepse nxënësve të Hanit të Elezit mund të ju hynë në punë dhe nuk jam kundër por unë mundem me të jem këndur që me një far mënyre detyrimisht i dërgon diku dhe tanë kur i kthen në njoftim të shkollë e keni bërë renditjen në mënyrë proporcionale që mendoj që ka qenë gabim për shkak se me një far mënyre e ke krijuar atë klasë por përsëri ke me shuar sepse ndoshta nuk do të ketë interesim për me mësuar. Është dashur me u përzierë nxënësit.

**Hyriete Isufi** thekson:- janë të përzierë ato dy drejtime të tjera shoqërore të cilët me kohë janë paraqitur.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 9. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2022 i N.P.L Pastrimi sh.a.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 10. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- në mbledhjen prindërore e cila u mbajt breng më e madhe prindërvë ishte pesha e rendë e çantave. Është java e katërt që nuk ju kanë dhënë shujtat fëmijëve nëpër shkolla. Jam informuar nga disa qytetarë që janë përzgjedhur pesë nxënës të cilët e kanë kryer klasën e nëntë dhe janë përzgjedhur për në Turki por me çfarë kritere janë përzgjedhur.

**Xhevahir Dernjani** thekson:- drejtoria e arsimit është për lëvdata, ndërsa sa i përket komisionit të aksionarëve tridhjetë e një ditë i ka ki muaj dhe besoj që do të na ftojnë. Për riciklimin është mirë me u bërë por kjo do të ndodh ndoshta me vite dhe nga momenti që vjen prej nivelit qendrorë do të bëhet. E përgëzojë drejtoreshën e shëndetësisë për mamografin që e ka sjellë te QKMF-ja. U diskutua çështja e shkollave profesionale por është problem me i hapur për shkak se duhet kuadro dhe pasi ka në komuna më të afërtë është mirë të shkohet sepse ndoshta më lehtë mund të punësohen.

**Ajnure Thaçi** thekson:- kush do t'i mbikëqyrë nxënësit që do të mbahet gara talent shou të dielën, kush do ta siguron transportin dhe ushqimin.

**Sherif Berisha** thekson:- në komitet për politik e financa kam kërkuar një raport me shkrim për çështjen e pensionistëve por nuk e kam pranuar. Kërkoj informacion rreth kualifikimeve për shkak se Kryetari i Komunës dhe drejtori i arsimit më herët kanë parashtruar padi për këtë çështje. Nuk e di se ku keni mbërrit me çështjen e pagesës për shkak se po i bëhet dy herë dëm komunës sepse disa e kanë dërguar lëndën për përbartim.

**Hisni Luri** thekson:- sa i paketë çantave janë ekspertët nga Ministria të cilët i kanë përcaktuar librat dhe ne krejt çka mundemi me ja përshtatur një orarin. Është mirë që të bëjmë digitalizimin përmes tabletave në mënyrë që të gjitha librat me i pasur në atë tabletë. Sa i përket shujtave ka qenë vendimi i Ministrat z. Hekuran Murati që i ka ndarë mjetet për shujtat nga klasa e parë deri në të pestën dhe mjetet i ka ndarë për secilën komunë në bazë të numrit të nxënësve dhe shuma e dedikuar për tek ne ka qenë shumë e vogël dhe ne kemi filluar me i ekzekutuar për mos humbur këtë kod buxhetorë në mënyrë që mos me u kthyer mjetet financiare për shkak se nuk kemi mundur me i shfrytëzuar për çështje tjera dhe nëse Ministria do të dedikon përsëri mjetet ne do të vazhdojmë me dhënë shujta. Pesë nxënësit të cilët do të shkojnë në Turqi për me i ndjekur mësimet fillimisht janë përzgjedhur dy nxënës të cilët janë më të mirët dhe pastaj kur është shtuar numri edhe për tre kemi kërkuar këshillat e fshatrave që të bëjnë përzgjedhjen dhe të gjithë nxënësit të cilët do të shkojnë janë të mirë. Çështjen e shkollave profesionale e kemi menduar por nuk kemi mundësi sepse duhet të kemi kabinete të veçanta. Të gjitha shpenzimet do të kryhen prej talent shou dhe e kemi përcaktuar një kordinatorë për këtë çështje. Çështjen e pagesës së kualifikimeve nuk mundemi me kryer prej mallrave dhe shërbimeve apo pagave për shkak se kanë pasur një keqkuptim në mes të Ministrive. listat e kime dërguar për me i kryer pagesat por Ministria e Financave nuk i ka ekzekutuar dhe janë detyruar të shkojnë me procedurë përbartimore

**Nora Xhoni** thekson:- u diskutua çështja e çantave të rënda të nxënësve por unë ftoj të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës që të participojnë me mjete financiare në blerjen e trollit për ndërtimin e një shkolle në Lagje të re për shkak se është në të mirë të komunitetit në mënyrë që të bëhen shkollat me një ndërrim.

**Sherif Berisha** thekson:- përsëndes iniciativën por kush do që merr iniciativa të tillë duhet të bënë analiza të mirëfillta pavarësisht që çdo herë e kemi kërkuar që të ketë një vend për shkollë por nuk kemi mundur me gjetur. Ne po e shohim që numri i nxënësve dita ditës po bien dhe nëse mendohet të mbyllët shkolla e fshatit Gorancë atëherë është një gabim në hapa por duhet të ua japim mundësin ekspertëve të arsimit në mënyrë që ta bëjnë një ekspertizë se a është e nevojshme që mos të hapim shkolla sikur që i kemi mbyllur të tjerat.

**Kryesuesi** thekson:- është iniciativë qytetarë dhe nuk besoj që është mirë me diskutuar në kuvend.

**Nora Xhoni** thekson:- nuk është e kundërligjshme nëse bëjmë ftesë për participim për shkak se është i treti mandat që kemi kërkuar që të bëhet një zgjidhje dhe tash po bëhet dhe nuk është e kundërligjshme nëse kërkojmë me participuar me mjete financiare. Është shumë e mirë për shkak se bëhet me një ndërrim shkolla dhe për pjesën tonë është më afër, ndërsa sa i përket ekspertëve themeluesit e iniciativë besoj që janë konsultuar për këtë çështje.

**Resul Suma** thekson:- në Han të Elezit është mungesa e një tregu ditorë ose një hapësirë që disa gjëra elementare produkte bujqësore e jo shitësit ambulantë me dal herë te Xhamia e herë te Posta dhe e nxajnë pronën publike. Në kompaninë Sharrcem nxehësia që prodhohet te furra me parashtruar kërkesë në kompaninë Sharrcem që ajo nxehësi me mundur me u përdorë për ngrohjen e institucioneve publike e ndoshta në të ardhmen edhe banesat.

**Xhevahir Dernjani** thekson:- edhe sa kohë do të qëndron mamografia te QKMF-ja dhe deri më tanë sa pacientë janë kontrolluar.

**Refet Kalisi** thekson:- a ka qenë interesimi i grave për me bërë mamografin dhe është mirë që t'i informojmë sa më shumë për këtë çështje.

**Malik Berisha** thekson:- a keni informacione sa i përket çështjes së stomatologut me kompaninë Sharrcem.

**Kimete Kuka -Hasallari** thekson:- gjatë tërë muajit kemi bërë aktivitet për të shënuar këtë muaj për ndërgjegjësim sa më të madh të femrave në komunën tonë. Kërkesën e kemi bërë për pesë ditë dhe një ditë ka munguar për shkak se ka pasur një defekt kamioneta. E kemi përcaktuar vetëm për pesëdhjetë gra dhe shpresojmë që rezultatet të na vijnë brenda javës. Interesimi është por numri është i kufizuar deri në pesëdhjetë persona për shkak të stafit të cilët nuk kanë të mjaftueshmë. Për çështjen e stomatologut ju ka drejtuar me kërkesë kompanisë Sharrcem dhe ka kaluar si projekt por tash e kam proceduar kërkesën për një karrik stomatologjike.

**Sevdi Dernjani** thekson:- për çështjen e pensionistëve kemi pasur një vendim nga zyra e kryetarit të komunës të cilën e kemi përcjell në procedura të prokurimit dhe është shpallur fituesi. Është përzgjedhur kompania që ka pasur me i dërguar pensionistët në Elbasan dhe në atë kontratë si kordinatorë është caktuar z. Shefket Lusnjani si kordinatorë dhe menaxher i kontratës ka qenë z. Naser Laqi. Vendimi i kryetarit ka qenë dashamirës sa i përket kësaj kategorie dhe vazhdimësia e kësaj procedure nuk ka shkuar siç duhet për shkak se ka pasur shumë ankesa nga pensionistët për shkak se nuk janë shoqëruar ashtu siç ka qenë me kontratë. Koordinatorin e kontratës e kam pas në zyre së bashku me disa pensionistë të tjera dhe e kemi diskutuar çështjen se kemi pasur ankesa. Koordinatori ka parashtruar ankesë ndaj kompanisë dhe besoj që sipas legjislacionit do të sankzionohet

**Sherif Berisha** thekson:- sa i përket çështjes së pensionistëve përgjegjësia i bien kryetarit të komunës dhe nënkyetarit por unë e di që kanë parashtruar ankesë ndaj kompanisë dhe moralisht keni përgjegjësi me i ftuar pensionistët për këtë çështje.

**Sevdi Dernjani** thekson:- ne nuk kemi pretendime për me i thënë dikujt për me bërë ankesë por e kemi ftuar kryesine pensionistëve e kemi diskutuar këtë çështje dhe e kemi ftuar pronarin e kompanisë dhe pronari i kompanisë në prezencë e ka pranuar se është fajtorë sa i përket këtij veprimi.

**Refet Kalisi** thekson:- është dashur me dërguar menaxherin e kontratës së bashku me pensionistët dhe besojë që nuk do të kishte problem.

**Majlinda Kaloshi** thekson:- jemi të interesuar për me pasur tregun por kemi edhe mungesë buxhetor, ndërsa çështja e ngrohjes së institucioneve publike është çështje që duhet të bëhet një studim i fizibilitetit.


**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:55

Procesmbajtësi

Aymn Bushi



Kryesuesi Kuvendit  
Florine Shkreta